



BIO

ERJONA REBI DOKTOR I SHKENCAVE

VËSHTRIM I PËRGJITHSHËM I KARRIERËS

Dr. Erjona Rebi është pedagoge pranë Departamentit të Qeverisjes, Shkencave Politike dhe Komunikimit

FUSHA E EKSPERTIZËS KËRKIMORE

- Analiza e tregut financiar
- Politikë monetare me fokus të veçantë në kreditim dhe ndërmjetësimin financiar

Erjona ka mbaruar studimet në profilin bankë - kontabilitet në Fakultetin e Ekonomisë, Universitetin e Tiranës në vitin 2001. Më pas, në 2006 ka finalizuar masterin në Studime Evropiane të Universitetit të Tiranës në bashkëpunim me Fakultetin e Bambergut në Gjermani. Prej me shumë se dy dekadash punon në Bankën e Shqipërisë, në Departamentin e Politikës Monetare. Gjatë kësaj kohe, është specializuar në analizën e tregut financiar dhe ndërlidhjet e sektorit bankar me politikën monetare, me fokus të veçantë në kreditim dhe ndërmjetësimin financiar.

Ajo ka kontribuar në përgatitjen e materialeve periodike të Bankës së Shqipërisë mbi zhvillimet makroekonomike. Gjithashtu ajo është përfshirë në shumë punime kërkimore në vlerësimin e faktorëve që ndikojnë në ndërlidhjen e tregut financiar dhe atë të pasurive të paluajtshme, si në vend ashtu edhe në rajon.

Gjatë punës së saj është angazhuar në përpilimin, analizimin dhe kryerjen e vrojttimeve bankare që kanë ndihmuar për të kuptuar më mirë zhvillimet makroekonomike dhe ato të sektorit financiar. Ndër vite ka qenë përfaqësuese e Bankës së Shqipërisë në grupet ndërministrorë për aksesin në financë të SME-ve dhe të grave në biznes.

Përveç përvojës së punës së fituar gjatë këtyre viteve, në vitin 2016 ka pasuruar më tej formimin akademik duke marrë titullin Doktorë e Shkencave në Bankë dhe Financë në Universitetin Tor Vergata në Romë, Itali.